

**V E N D I M**  
**Nr.6, datë 10.7.1995**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                  |         |                        |
|------------------|---------|------------------------|
| Rustem Gjata,    | Kryetar | i Gjykatës Kushtetuese |
| Feti Gjilani ,   | Anëtar  | i “““                  |
| Hilmi Dakli,     | Anëtar  | i “““                  |
| Manol Konomi,    | Anëtar  | i “““                  |
| Veli Budo,       | Anëtar  | i “““                  |
| Franc Jakova,    | Anëtar  | i “““                  |
| Alfred Karamuço, | Anëtar  | i “““                  |
| Zija Vuci,       | Anëtar  | i “““                  |
| Metush Saraçi,   | Anëtar  | i “““                  |

me sekretare Drita Filto, më datat 6.6.1995 dhe 9.6.1995, 10.7.1995, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.7 Akti, që i përket:

**K Ë R K U E S E:** DHOMA E AVOKATËVE TIRANË, e përfaqësuar nga Maksim Haxhia, kryetar i Dhomës së Avokatëve dhe Avokatët Thimjo Kondi e Ylvi Myrtja.

**O B J E K T I**

Të shpallen antikushtetuese dhe të shfuqizohen nenet 5, 25 dhe 26 të ligjit nr.7827, datë 31.05.1994 “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë” mbështetur në nenin 2 e 10 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, nenet 2, 16, 24 pika 2 e 9 dhe nenit 25/2 të Ligjit Kushtetues “Për Organizimin e Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese”, neneve 18, 20 dhe 28 të Ligjit Kushtetues “Për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut”.

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relacionin përkatës,

**V Ë R E N:**

Dhoma e Avokatëve të Tiranës në kërkesën dhe në parashtresën e paraqitur më vonë nga përfaqësuesit e saj, kërkon shpalljen të

papajftueshme me Ligjin Kushtetues nr.7491, datë 29.4.1991 të neneve 5. 25 e 26 të ligjit “Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, duke u mbështetur kryesisht në dispozitat e neneve 2 e 10 të ligjit kushtetues të përmendur më sipër, si dhe në nenin 16 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për Organizimin e Drejtësisë dhe Gjykatën Kushtetuese” dhe në standartet ndërkombëtare.

Dhoma e Avokatëve, referuar në normat e ligjit kushtetues, ngreh këto dy pretendime: a) Avokati nuk mund t’i shtrohet pengesës që të ushtrojë veprimtari tregtare në emër të tij ose në emër të të tjerëve, b) Organizimi i provimeve dhe përjashtimi i një kategori avokatësh nga ky detyrim nuk duhet të lihet në kompetencën e Ministrit të Drejtësisë, për arsye se preket pavarësia dhe parimi i vetëqeverisjes së avokatisë si profesion i lirë.

Gjykata e çmon të nevojshme që të japë përmbajtjen tekstualisht të neneve 2 e 10 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese”.

Neni 2 : “Republika e Shqipërisë është shtet juridik dhe demokratik.

Dinjteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, zhvillimi i lirë i personalitetit të tij si dhe rendi kushtetues, barazia para ligjit, drejtësia shoqërore e përkrahja shoqërore dhe pluralizmi janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë e mbrojë ato”.

Neni 10 : “Ekonomia e vendit bazohet në shumëllojshmërinë e pronave, iniciativën e lirë të të gjitha subjekteve ekonomike dhe në rolin rregullues të shtetit.

Iniciativa ekonomike e personave juridikë dhe fizikë nuk mund të zhvillohet në kundërshtim

me interesin shoqëror dhe nuk duhet të çenojë sigurinë, lirinë dhe dinjitetin e njeriut”.

Nga një shqyrtim i hollësishëm i këtyre dy normave del e qartë se nuk ka asnjë lidhje në mes këtyre normave dhe pretendimeve të palës kërkuuese.

Nuk është e pranueshme që avokatia, ndonëse e cilësuar nga ligji si profesion i lirë, të barazohet ose të njësohet me profesionet e tjera të lira. Parimi i pluralizmit në një shoqëri të tregut të lirë, shumëllojshmëria e pronave, iniciativa e lirë etj., nuk janë argumenta dhe nuk mund të shërbejnë për të arritur në konkluzionin e sipërm.

Çdo profesion i lirë ka specifikën e vet, ka rregullat, ka detyrat që zbatohen në këtë profesion, që përfshihen dhe përbëjnë kodin deontologjik të tij.

Avokatia është një profesion i lirë, por dimensionet e karakterit të lirë të avokatisë nuk mund të përcaktohen duke marrë për bazë normat e neneve 2 e 10 të ligjit “Për dispozitat kryesore kushtetuese” dhe parimet që shprehin këto norma.

Ligjvënësi kushtetues e ka veçuar profesionin e avokatisë dhe me dispozitë të veçantë, me nenin 16 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, ka përcaktuar karakterin e saj. Në këtë nen thuhet në mënyrë të shprehur: “Avokatia ushtrohet si profesion i lirë. Veprimtaria e avokatisë rregullohet me ligj”.

Neni 16 duhet të merret dhe të analizohet në tërësinë e tij dhe është pikërisht pjesa e dytë e kësaj dispozite që përcakton dimensionet e avokatisë si profesion i lirë. Kjo pjesë e dytë e nenit 16 jo vetëm që nuk e redukton “në minimum” rolin rregullues të shtetit, por në të kundërtën, i njeh shtetit një rol aktiv.

Avokatia e cilësuar si profesion i lirë dhe jo në varësi shtetërore, ka një karakter thellësisht social dhe publik. Misioni dhe roli që duhet të lojë avokati në një shoqëri civile është i një rëndësie primare. Ai është “ndërgjegjja kritike” në një demokraci.

Gjykata do të kufizohet të përmendë vetëm faktin se Dhoma e Avokatëve kërkon të shpallet antikushtetues neni 5 i ligjit “Për Avokatinë”, që ndalon avokatin të ushtrojë në emër të tij ose në emër të të tjerëve veprimtari tregtare, për t’u vërtetuar se ajo nuk ka të formuar një koncept të qartë mbi rolin dhe misionin e avokatit si faktor social i rëndësishëm dhe një nga komponentët në dhënien e drejtësisë. Duke kërkuar që rolin rregullues të shtetit t’i jepen proporcione shumë të reduktuara dhe kështu ndërhyrja e tij të kufizohet në minimum, do të thotë që ky problem të shqyrtohet në mënyrë krejt simpliste.

Në nenin 5 të ligjit “Për Avokatinë” shprehet ndër të tjera që: “Avokati nuk mund të jetë në të njëjtën kohë përfaqësues i çdo lloj kulti fetar”. Kjo ka për qëllim që të ndalojë avokatin të jetë përfaqësues i një kulti fetar, si klerik dhe të ushtrojë këtë funksion, por jo ta ndalojë atë, të jetë përfaqësues në mbrojtje të interesave të tyre pasurore.

Pretendimi i Dhomës së Avokatisë, që avokati nuk mund të pengohet të ushtrojë veprimtari tregtare në emër të tij ose në emër të të tjerëve është pa vend, dhe nuk mund të pajtohet me misionin që ka avokati në dhënien e drejtësisë. Shtojmë se në nenet 2 e 3 të ligjit nr.7632, datë 4.11.1992 të Kodit Tregtar, përkufizohet në mënyrë të plotë se çfarë duhet kuptuar me tregtarë dhe veprime tregtare.

Dhoma e Avokatëve në mbrojtje të pretendimeve të saj në lidhje me nenet 25 e 26 të ligjit “Për Avokatinë”, jashtë logjikës së ligjit thekson se këto nene kanë për qëllim heqjen e ushtrimit të profesionit të avokatit disa juristëve, pavarësisht se ata kanë të gjitha cilësitë morale e profesionale dhe se me këto dispozita, nuk cënohen vetëm avokatët, por të gjitha shoqatat politike, ekonomike, tregtare, kulturore, sportive. Gjykata Kushtetuese e ka të vështirë të gjejë lidhjen logjike ose ligjore në mes këtyre pretendimeve dhe kërkesës për të shpallur nenet 25 e 26 të Ligjit “Për Avokatinë” antikushtetuese.

Dhoma e Avokatëve pretendon se dhënia e provimit të kualifikimit përpara një komisioni të caktuar nga Ministri i Drejtësisë, e ve institucionin e avokatisë në varësi të ekzekutivit, gjë që vjen në kundërshtim me karakterin e lirë, të pavarur dhe vetëqeverisës të këtij institucioni.

Kjo pikëpamje e Dhomës së Avokatëve mbështetet, siç është edhe rasti i nenit 5, në konceptin që ajo ka për profesionin e avokatit dhe në dimensionet që i jep nocionit “profesion i lirë”.

Gjykata çmon se organizimi i provimeve të kualifikimit të avokatëve sipas nenit 25 dhe 28 (çdo pesë vjet), ka për qëllim të vetëm ngritjen e nivelit profesional të avokatit, azhurnimin e tij me kërkesat e kohës në fushën juridike, dhe nuk mund të pranohet se këto dispozita synojnë të venë në varësi të ekzekutivit profesionin e avokatisë.

Provime kualifikimi parashikohen dhe organizohen edhe për ngritjen profesionale të

gjyqtarëve, por ato nuk mund të kenë kurrësesi për qëllim dhe nuk mund të pretendohet se çënojnë pavarësinë e tyre.

Dihet se ligji dhe dispozita të veçanta, kanë vlerën

e tyre të brendshme, por vlera e tyre përcaktohet në një farë mase edhe nga mënyra e zbatimit të tyre, përveç arsyeve të tjera, edhe për vetë faktin se ligjvënësi nuk mund të parashikojë të gjitha vështirësitë ose rastet që paraqiten në kohën e zbatimit, por mungesat dhe gabimet e vërtetuara nuk janë shkaqe, nuk mund të shërbejnë si bazë për të shpallur ligjin ose një dispozitë të tij të veçantë si antikushtetuese.

Në këtë prizëm duhet të shqyrtohet edhe përmbajtja e nenit 26 edhe jo duke ngritur hipoteza si në lidhje me nenin 25. Neni 26 cakton kriteret mjaftësisht të sakta për të përjashtuar një kategori avokatësh nga detyrimi i provimit.

Gjykata e quan të udhës të verë në dukje se pretendimi i Dhomës së Avokatisë se me nenet 25 dhe 26 të Ligjit “Për Avokatinë”, çënohet si parimi i ndarjes së pushteteve dhe ai i të drejtave të fituara, nuk është racionale. Parimi i ndarjes së pushteteve shkelet kur kemi interferenca të një pushteti në kompetencat e tjetrit. Në rastin konkret ligjvënësi vetë i ka deleguar Ministrin të Drejtësisë, që përfaqëson ekzekutivin, të drejtën e organizimit të provimeve të kualifikimit të avokatëve dhe të përjashtimit nga provimi të avokatëve që plotësojnë kërkesat e ligjit. Nga ana tjetër në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me të drejta të fituara dhe me cënimin e këtyre të drejtave, po të merret parasysh, përveç të tjerave, neni 28 të ligjit “Për Avokatinë”, i cili parashikon se avokati, që ka marrë lejen dhe ushtron profesionin e tij, i nënshtrohet provimit të kualifikimit çdo 5 vjet.

Pretendimet e Dhomës së Avokatisë nuk gjejnë mbështetje as në aktet ndërkombëtare për avokatinë. Në “Parimet bazë lidhur me rolin e avokatëve”, të miratuara në vitin 1990, theksohet se autoritetet publike duhet të kujdesen për formimin e avokatëve dhe për krijimin e kushteve të barabarta për të hyrë në profesionin e avokatit”.

#### PËR KËTO ARSYE;

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24, 25 e 26 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me shumicë votash,

#### V E N D O S I:

Rrëzimin e kërkesës së Dhomës së Avokatëve Tiranë.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

Votuan kundër këtij vendimi : Feti Gjilani, Veli Budo e Zija Vuci.

#### MENDIMI I PAKICËS

I nënshkruari jam kundër këtij vendimi të shumicës por vetëm në atë pjesë që rrëzon kërkesën e Dhomës së Avokatëve Tiranë për shpalljen antikushtetues të neneve 25 e 26 të ligjit nr.7827, datë 31 Maj 1994 “Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë”.

Në nenin 25 të këtij ligji është sanksionuar shprehimisht se : “Provimi i kualifikimit jepet përpara një komisioni të caktuar nga Ministri i Drejtësisë. / ... Rregullat për funksionimin e komisionit, lëndët profesionale dhe mënyra e dhënies së provimit caktohen nga Ministri i Drejtësisë. / Në këtë komision merr pjesë edhe një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Avokatëve”.

Ndërsa në nenin 26 është përcaktuar, ndër të tjera, tekstualisht sa vijon : “Përjashtimi nga detyrimi për dhënien e provimit të kualifikimit mund të bëhet me urdhër të Ministrin të Drejtësisë...”.

Përmbajtja e këtyre dy dispozitave është antikushtetuese sepse çënon parimin se avokatia është një profesion i lirë dhe i pavarur. Ky parim është sanksionuar në normat e disa dokumenteve ndërkombëtare të gjithëpranuara dhe e ligjeve kushtetuese në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Më konkretisht :

1. Dokumenti datë 29 qershor 1990 i Mbledhjes së Kopenhagenit të Konferencës së KSBE mbi Dimensionin Njerëzor në nenin 5, pika 13 përcakton tekstualisht se : “Pavarësia e avokatëve do të njihet e do të mbrohet sidomos për sa u përket kushteve të rekrutimit dhe ushtrimit të veprimtarisë së

tyre”.

Po kështu në nenin 20, pika 4, të Dokumentit datë 3 tetor 1991 të Mbledhjes së Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor që KSBE mbajti në Moskë u rikonfirmuan, ndër të tjera, detyrat për:

a) arsimimin dhe përgatitjen e gjyqtarëve dhe avokatëve; b) përgatitjen dhe zbatimin e ligjeve, që synojnë të forcojnë respektimin e pavarësisë jo vetëm të gjyqtarëve, por edhe të avokatëve”.

2. Në nenin 8 të ligjit nr.7491, datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” është sanksionuar se : “Ligjislacioni i Republikës së Shqipërisë merr parasysh, njeh dhe respekton parimet dhe normat përgjithësisht të pranura të së Drejtës Ndërkombëtare”. Sikurse dihet, Shqipëria është anëtare e KSBE-së që nga viti 1991.

Gjithashtu në nenin 16 të ligjit tonë kushtetues nr.7561, datë 29 prill 1992 është përcaktuar se : “Avokazia ushtrohet si profesion i lirë”, ndërsa në nenin 1 të ligjit organik të lartpërmendur pranohet shprehimisht parimi se : “Avokazia në

Republikën e Shqipërisë ushtrohet si profesion i lirë dhe i pavarur”.

Nga sa u parashtrua më lart konkludohet pa asnjë mëdyshje se karakteri i lirë dhe i pavarur i profesionit të avokatit, që është sanksionuar në norma të gjithëpranuara të së Drejtës Ndërkombëtare e të legjislacionit kushtetues të Republikës së Shqipërisë, nënkupton domosdoshmërisht nëvetësinë apo vetëqeverisjen e Dhomave të Avokatëve dhe të Dhomës Kombëtare të Avokatëve, të cilët janë persona juridikë dhe kanë prerogativa, që, për nga natyra juridike e tyre, nuk mund të merren e të zbatohen nga asnjë organ shtetëror. Në fakt, tashmë edhe në Shqipëri avokazia është një shoqatë apo urdhër i mëvetësishëm.

Si rrjedhojë, është antikushtetuese që Ministrit të Drejtësisë t’i jepen edhe kompetencat e përshkruara në nenet 25 e 26 të ligjit të tanishëm “Për avokatinë në Republikën e

Shqipërisë” të cilat nuk mund t’i përkasin një organi ekzekutiv, sepse ato janë, në rrafshin kushtetues, prerogativa ekskluzive të Avokatisë si shoqatë e mëvetësishme, që ka organizimin përfaqësues profesional të saj, të caktuar në Kreun III të këtij ligji.

Për më tepër nenet 25 e 26 vijnë në kundërshtim edhe me një sërë dispozitash të vetë ligjit “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”. Kështu në nenin 17, pika 1, thuhet se “Mbledhja e përgjithshme e Dhomës së avokatëve ka edhe kompetencën që të marrë masa për përgatitjen e vazhdueshme profesionale të avokatëve”. Neni 20, paragrafi 4, i jep të njëjtën kompetencë Dhomës Kombëtare të Avokatëve. Më tej nenet 23 e 28 i njohin Ministrit të Drejtësisë vetëm kompetenca mbikqyrëse e jo kurrësesi ekzekutive-urdhërdhënëse, siç është vepruar në hartimin e neneve 25 e 26.

Argumentet e parashtruara më lart imponojnë që këta dy nene të Ligjit “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë” të shpallen antikushtetuese.

A N Ë T A R  
Feti Gjilani

## MENDIMI I PAKICËS

Jam kundër vendimit që e quan të drejtë dhe në përputhje me dispozitat kryesore kushtetuese nenin 26 të ligjit “Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, sepse përmbajtja e këtij neni vjen në kundërshtim me dispozitat kryesore kushtetuese që deklarojnë avokatinë si profesion të lirë si dhe me vetë nenin 1 po të këtij ligji që e cilëson institutin e avokatisë njëkohësisht edhe të pavarur.

Shteti dhe shoqëria janë drejtpërdrejt të interesuar për kualifikimin e vazhdueshëm të avokatëve për arsye të rëndësishme të madhe që ka ky institucion si ndihmës i drejtësisë, për pozitën që ai zë në ushtrimin e funksionit kushtetues të së drejtës së mbrojtjes dhe për të dhënë sa më të kualifikuar ndihmën juridike personave të veçantë.

Ligjvënësi me këtë dispozitë duhet të vendoste vetëm kriteret me të cilat të përcaktohej rrethi i personave që duhet t’i nënshtroreshin provimit si dhe ata që duhet të kiheshin parasysh për të përjashtuar nga provimi i kualifikimit avokatë të caktuar. Caktimi kush do t’i nënshtrohej provimit të kualifikimit çdo 5 vjet e kush jo, duke u nisur nga kriteret e vendosura me ligj, duhej të lihej në dotë të vetë avokatëve, për të cilët do të vendoste Dhomat Kombëtare e Avokatëve dhe jo në kompetencën e Ministrit të Drejtësisë përderisa ky profesion është i lirë dhe një institucion i pavarur. Këtë qëndrim mendoj se e ka ligjëruar edhe vetë neni 28 i po këtij ligji, në paragrafin e dytë të të cilit thuhet shprehimisht se : “Ministri i Drejtësisë mbikqyr zbatimin e rregullave për dhënien e provimit të

kualifikimit dhe anullos atë kur vëren shkelje të rregullave përkatëse”.

**A N Ë T A R I**  
**Veli Budo**

### **MENDIMI I PAKICËS**

Nuk bashkohen me vendimin e dhënë me shumicë votash që nuk e shfuqizoi si antikushtetuese vetëm atë pjesë të nenit 26 të ligjit nr.7827, datë 31.05.1994 “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, e cila i njeh të drejtën ekskluzive Ministrit të Drejtësisë të përjashtojë nga detyrimi për dhënien e provimit të kualifikimit të një kategorie të caktuar juristësh.

Në këtë dispozitë të ligjit janë përcaktuar kriteret për përjashtimin nga ky detyrim, por lënie për zbatim e tyre vetëm në çmimin subjektiv të Ministrit të Drejtësisë është e mbarsur me disa pasoja negative.

Në radhë të parë, atij si përfaqësues i pushtetit ekzekutiv i hapet rruga për të vënë nën tutelë avokatinë, në një kohë kur nga normat tona kushtetuese dhe ato ndërkombëtare të gjithëpranuara është sanksionuar parimi se avokatia ushtrohet si profesion i lirë dhe i pavarur.

Së dyti, ekziston mundësia që Ministri, duke e pasur një kompetencë të tillë ta ushtrojë atë, duke u bazuar në konsiderata personale ose në opinione jo të sakta që mund të ketë krijuar për avokatët, aparati i tij tepër i pakët në numur, i cili nuk lidhet drejtpërsëdrejti me punën e tyre ose që këto lidhje ai i ka tepër të kufizuara dhe që kanë të bëjnë vetëm me anën administrative të avokatisë.

Në këto rrethana, ashtu siç ka ndodhur deri më sot, që të përfitojnë padrejtësisht dhe të vazhdojnë të ushtrojnë profesionin si avokatë, juristë që nuk kanë përgatitjen e mjaftueshme profesionale ose të mos përfitojnë nga e drejta për t’u përjashtuar nga dhënia e provimit të kualifikimit disa të tjerë, me një përgatitje të mirë profesionale.

Nuk është e vështirë të kuptohet se krijimi i kësaj situate mund të ndikojë në dobësimin e punës së organeve të drejtësisë dhe për rrjedhojë të dëmtojë dhënien e drejtësisë, kur dihet se një nga komponentët e saj është edhe veprimtaria e avokatisë.

Prandaj jam i mendimit që në nenin 26 të ligjit “Për avokatinë në Republikën e Shqipërisë” të shfuqizohen si antikushtetuese vetëm fjalët: “me urdhër të Ministrit të Drejtësisë”, ndërsa pjesa tjetër e kësaj dispozite, që ka të bëjë me kriteret për përjashtimin nga detyrimi për dhënien e provimit të kualifikimit, duke mbetur ashtu siç është, fare mirë mund të gjejë zbatim duke u mbështetur në paragrafin e tretë të nenit 25 të ligjit të lartpërmendur, përderisa aty është parashikuar shprehimisht se: “Rregullat për funksionimin e komisionit, lëndët profesionale dhe mënyra e dhënies së provimit caktohen nga Ministri i Drejtësisë”.

**A N Ë T A R I**  
**Zija Vuci**